



Lajmëtari i Radio Marisë

Maj 2011

Viti III, Nr. 5

Në këtë numër do të lexoni

- Totus Tuus - Shpresojmë në Virgjërën 2
- Frekuenca e fortë e Radio Marisë është Dashuria 3
- Kisha lumturon Papën Gjonin Palin II 3
- Festa e Mëshirës Hyjnore në Radio Mari 4

Lajmëtari i Radio Marisë është organ i Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4

Fushë Kërçik

Babrru, Paskuqan

Tiranë, Shqipëri

+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II

Shkodër, Shqipëri

+355 22 24 08 52

E-mail

info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

Radio Maria,

Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde, mund të dëgjohet në:

Prëshen e rrethina

FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat

FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin

FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras

FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,

Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

www.radiomaria.al

“TOTUS TUUS” - MBËSHTETJA NË MARINË, NËNËN E MËSHIRËS

Të dashur miq, familja e madhe e Radio Marisë gëzohet me mbarë Kishën për lumturimin e Atit të shenjtë Gjonit Palit II. Ky Papë i Madh na ka lënë pas një trashëgimi shumë të pasur. Por, ne i jemi mirënjohës atij që na mësoi me fjalë e mbi të gjitha me shembullin e jetës që të kemi besim në Mëshirën hyjnore dhe në Marinë. Bëhet fjalë për dy përshpirtëri që ai i jetoi në mënyrë intensive në jetën e vet, si të ishin një përshpirtëri e vetme. Që nga rinia, Papa polak, duke lexuar Librin e Shën Ludovik Maria Grinjon de Monfortit, “Traktati i përshpirtërisë së vërtetë ndaj Marisë”, ia kushtoi krejt jetën e vet Jezusit përmes Marisë, duke e ripërtërirë këtë kushtim publikisht në çastet më të vështira e dramatike të pontifikatit. Pasi u bë Arqipeshkë i Krakovit, ai punoi që Kisha ta njohë përshpirtërinë ndaj Mëshirës hyjnore sipas zbulësive që mori Motër Faustina Kovalska nga Jezusi. E pasi u zgjodh Papë, e ngriti në nder të altarit Shën Faustinen dhe e themeloi Festën e Mëshirës hyjnore.

Rëndësinë dhe efektshmërinë e dorëzimit Marisë, Nënës së Mëshirës për jetën e krishterë, e shikojmë në jetën e Gjonit Palit II. Zoja e drejtoi gjatë një jete plot me kundërshtime e rreziqe, e mbrojti nga vrasësit, e bëri një dritë të shndritshme për mbarë botën, dhe pontifikatin e tij e bëri ndër më të rëndësishmit për historinë e Kishës. E tani, vetëm 6 vjet pas vdekjes, Kisha e njëjzë zyrtarisht e në mënyrë solemne shenjtërinë e tij. Kur jetën tonë ia dorëzojmë Zojës, ashtu që Ajo të mund ta përftojë sipas vullnetit të Hyjit, ajo bëhet një kryevepër bukurie e shenjtërie në duart e saj. Jeta e Gjonit Palit II iu tregon të gjithëve se sa e rëndësishme është që të mësohemi t'i dorëzohemi Marisë, në atë mënyrë që Nëna jonë qiellore të mund të na ndihmojë për ta realizuar projektin e Hyjit në ne.

Për ta jetuar dorëzimin tonë Marisë, siç bënte Gjonit Pali II, duhet para së gjithash ta pranojmë Zojën si Nënë tonën, që të jemi bijtë e saj, sipas vullnetit të Jezusit. Kështu Maria ndërhyr në jetën tonë, na merr dhe na drejton me urtinë e saj e na mbron me ndërmjetësimin e vet. Na dhurohet një mundësi e madhe për të përballuar udhëtimin e madh drejt portit të amshimit duke pasur përkrah praninë e ëmbël të Marisë. Ky është udhëtim i rrezikshëm gjatë të cilit mund edhe të zhdukemi. Shkatërrimi i anijes sjell vdekjen e sigurt e të përjetshme, dhe realisht kjo është ajo hije që e përcjell secilin njeri deri në frymëmarrjen e fundit. Perandoria e errësirës nuk lë pa i përdorur të gjitha mjetet për të na përpirë në humnerë. Nëse e marrim dhuratën e Jezusit dhe e pranojmë Nënë e Tij, Ajo do të

hyjë ëmbëlsisht në jetën tonë, duke e shndritur me dritën e saj dhe duke e mbrojtur me forcën hyjnore që ka përmes ndërmjetësimit. Nëse e marrim për dore, ajo nuk do të na braktisë kurrë. Nëse ecim ngadalë, ajo na pret; nëse rrëzohemi, ajo na ngre; nëse humbasim rrugën, ajo na kërkon. Nëse nuk largohemi nga zemra e saj amnore, do të jemi gjithmonë të sigurt. Duke e kapërcyer së bashku me Zojën oqeanin e jetës, e kemi sigurinë që një ditë do të arrijmë në limanin e dritës së jetës së pasosur, ku ajo na pret në Mbretërinë e gëzimit.

Dorëzimi Zojës duhet të jetohet në përmasën e përditshmërisë që ripërtërihet në fillimin dhe në mbarimin e çdo dite. Ta fillojmë ditën e re me lutje, ku duke iu dorëzuar Zojës i kërkojmë që të na drejtojë kah njohja e vullnetit të Hyjit e të na ndihmojë ta kryejmë atë. Ajo vetë ka jetuar duke e pranuar çdo ditë vullnetin hyjnor e tani është e gatshme të na shndrisë që çdo hap i yni të jetë në drejtim të drejtë e çdo mendim e veprim të jenë sipas dëshirës së Hyjit. Ajo i merr të gjitha ato drita dhe frymëzime të Shpirtit Shenjt, duke u përgjigjur në to në çdo çast të ditës e duke e mbushur me domethënie hyjnore. Virgjëra e urtë na drejton në zgjedhjen e të mirës në vend të së keqes, na i zbulon rreziqet e fshehura të armikut. Ajo na mbështet në vështirësi e na sjell te fitorja në çdo betejë të shenjtë, na ngre nga të gjitha rëniet, i shëron plagët e i kufizon dëmet e gabimeve tona. Prania e saj i jep kuptim ditës tonë, e mbush me margaritarë të bukurisë së përjetshme.

Ne nuk duhet ta lëshojmë kurrë dorën e saj. Mund të ndodhë që ritmi i shpejtë i ditëve të na bëjë ta harrojmë praninë e saj. Mirëpo sa të vetëdijesohemi, ta thërrasim atë me anë të lutjes. Ajo nuk na lë të presim. Kur e thërrasim, ajo është gjithmonë e gatshme të na dalë në ndihmë. Kur arrijmë në përfundimin e ditës, të ndalemi një çast që të pushojmë në zemrën e saj. Nuk ka ripërtëritje më të mirë të dashurisë sesa dashuria e një nëne! Ajo do të na ndihmojë që t'i përmirësojmë gabimet, që të marrim fuqinë për ta filluar përsëri ditën e re me zell të ri dhe besim. Buzëqeshja e saj është bar shërues që shëron të gjitha frikësimet, dëshpërimet, paaftësinë dhe shkuraqimet tona si njerëz. Dita me Marinë është një hyrje e parajsës.

I Lumi Gjonit Pali II, nga qielli, na nxjerr të hiri që të jetojmë dorëzimin tonë Marisë, Nënës së Mëshirës, sikurse ai e ka jetuar, në mënyrë që të jemi edhe ne një ditë me të afër Nënës së Hyjit në Mbretërinë e qiellit.

Padre Livio Fanzaga

TOTUS TUUS - SHPRESOJMË NË VIRGJËRËN



Të dashur dëgjues dhe miq të Radio Marisë, me gëzim të madh dëshiroj të bashkëndaj me ju një moment reflektimi në këtë ditë kaq të veçantë siç është kremtimi i Mëshirës hyjnore, në përgatitjen e mbarë Kishës që do ta kremtojë të dielën e ardhshme, më 1 maj.

Papa Gjoni Pali II, kur e ftoi Kishën për kremtimin e Jubileut të Madh në vitin 2000, na foli për shenjat që në botën e sotme duhet të flasin për mëshirën hyjnore nëpërmjet nesh të krishterëve. Me atë rast shkroi: «Një shenjë e Mëshirës së Hyjit, sot sidomos e nevojshme, është shenja e dashurisë, që hap sytë tanë para nevojave të atyre që jetojnë në varfëri dhe të braktisur. Këto janë ato situata që shtrihen sot në shumë pjesë shoqërore dhe me hijen e vet mbulojnë me vdekje shumë popuj

në tërësi. Njerëzimi në përgjithësi është përballë formave të skllavërive të reja, shumë më të fshehura se ato që njohim nga e kaluara; liria vazhdon të jetë për shumë njerëz një fjalë që nuk ka përmbajtje. Duhet të ndërtohet kultura e re e solidaritetit dhe e bashkëpunimit». Për të kjo do të thotë: të lirohen të burgosurit, të mësohen analfabetët, të korrigojë ai që gabon, të ngushëllohet ai që është i trishtuar. Pra, bëhet fjalë për vepra të bamirësisë, vepra të mëshirës që na bëjnë të kuptojmë se vetë RADIO MARIA ËSHTË NJË VEPËR E BAMIRËSISË SË ZOJËS PËRBALLË FAMILJES SË MADHE NJERËZORE, sidomos përballë më të varfërve dhe atyre që nënçmohen në sytë e një bote që diskriminon ata që nuk prodhojnë.

Në të njëjtën mënyrë, Papa Benedikti XVI tregoi mënyrat e ndryshme që të kërkojmë ta sjellim praninë e Krishtit të ngjallur në kulturën e sotme. Sepse, nëse Jezusi nuk është i pranishëm në shoqërinë e sotme, nuk do të kemi themel të vërtetë në të cilin mund të qëndrojmë për të mbrojtur dinjitetin e personit njerëzor, thirrjen e tij në shenjtëri dhe jetën e pasosur.

Radio Maria ofron këtë vepër bamirësie duke filluar nga mësimet e Kishës, e vërteta e Jezu Krishtit, njeriu dhe Kisha. Kjo është e mundur falë provanisë e dashurisë së qindra e mijëra vullnetarëve dhe bashkëpunëtorëve, të pranishëm në 60 vende ku Radio Maria transmeton. Prapëseprapë, ky mision, kjo vepër e bamirësisë së ngutshme për kohën tonë, është në gjysmën e udhëtimit të vet, përderisa nuk ia del të mbulojë krejt sipërfaqen e vendit ku vepron dhe të mos e mbulojë mbarë botën.

Sot kemi nevojë që të gjithë t'i drejtojmë zemrat tona drejt Hyjit, që ta zbulojmë praninë e tij, duke marrë si model të dëgjimit dhe të përgjigjes Nënë e Jezusit: Zojën Mari. Kjo na lejon, atëherë, të zbulojmë se brenda veprave të bamirësisë, që lindin përbrenda Radio Marisë, është veprimi për ta PROMOVUAR, duke kërkuar që tek të gjithë të arrijë Fjala e jetës. Pra, të dashur miq dhe dëgjues, promovimi i Radio Marisë është një vepër e vërtetë e mëshirës.

Por, kush mund ta bëjë promovimin? Nëse ka një gjë në të cilën mund të marrin pjesë të gjithë, ky është promovimi. Të gjithë dëgjuesit në botë, fëmijët, të rinjtë, të rriturit, punëtorë apo studentë, të shëndoshë apo të sëmurë, të gjithë mund të bëjnë që Radio Marinë ta njohin miqtë e tyre, familjarët... Gjeni mënyrën që t'i ndihmoni ata që ta dëgjojnë ndonjë program, dhe kjo do të jetë për ta një ndihmë e madhe. Shfrytëzoni çastet e lutjes që t'i ftoni t'ju bashkëngjiten, duke rizbuluar së bashku me ta vlerën e lutjes së përbashkët. Hiri i Hyjit kalon përmes angazhimit tonë. Nëse në këtë kohë Pashkësh, secili dëgjues i Radio Marisë në botë t'ia dilte mbanë që Radio Maria të njihet në vendin e vet vetëm nga dy persona më shumë, atëherë radioja jonë do ta trefishonte dëgjueshmërinë në botë dhe së bashku me ta do të kremtonte Rrëshajat që do të jenë më 12 qershor, në mënyrë që të jenë të ripërtërirë, të ndezur me zjarrin e Shpirtit Shenjt. Për këtë arsye, të dashur dëgjues, të përfitojmë nga ky rast për ta praktikuar Mëshirën duke e promovuar Radio Marinë.

Promovimi është vepër e mëshirës së veçantë nga ana e atyre që marrin pjesë drejtpërdrejt në përgjegjësinë për ta çuar përpara misionin e Radio Marisë, dua të them drejtorët e radiove. Për këtë arsye, në cilësinë e Presidentit të Familjes botërore, dëshiroj t'u drejtohem të gjithë juve, dëgjues të Radio Marisë, që ta dëgjoni fjalën e Meshtarëve drejtorë për të vazhduar udhëtimin që ata e kanë përcaktuar si një referim të vërtetë për promovimin e Radio Marisë. Drejtori i Radio Marisë është bari që ushqen grigjën dhe është drejtues që çdo ditë udhëton së bashku me popullin e Hyjit, duke bërë që të dëgjohej zëri i Tij, sepse ai është referuesi i parë që mundet më së shumti ta promovojë Radio Marinë në mbarë botën.

Dëgjuesit, duke përvetësuar fjalët e drejtorëve të tyre meshtarë, mund të kuptojnë në mënyrë të shkëlqyeshme karakteristikat e kësaj vepre të Marisë së shenjtë duke bërë që Radioja të rritet e të zhvillohet në çdo vend ku vepron, si shprehje e juaja të dashur dëgjues, sepse e mbështetni përparimin e saj, duke u përpjekur që Radio Marinë ta zbulojnë dhe ta dëgjojnë të gjithë, si vepër për të gjithë dhe e të gjithëve. Prapëseprapë, kjo vepër e mëshirës, i angazhon edhe drejtuesit e programeve dhe Selinë e Radio Marisë, të gjithë vullnetarët e territorit të veçantë, Presidentin e Shoqatës. Në cilësinë e Presidentit dhe në cilësinë e VULLNETARIT të Radio Marisë, e njoh rëndësinë e të gjitha ecjeve të nevojshme për të zhvilluar në mënyrë të organizuar promovimin e Radios. Ky promovim zhvillohet me forcën e ndihmës reciproke së bashku me vullnetarët.

Për këtë arsye, e dashura Familje e Radio Marisë, duke u kthyer atje ku e nisëm bisedën, promovimi si vepër e mëshirës, kaq e rëndësishme për projektin e Radio Marisë në botë na bëri që këtë vit ta quajmë VIT TË PROMOVIMIT TË RADIO MARISË. Pra, të bashkohemi që të rritemi së bashku, të rritemi duke thirrur ata që nuk e njohin, ose nuk marrin pjesë nga afër në këtë mision, që të bëhen protagonistë dhe misionarë, bashkëpunëtorë të ngushtë të kësaj vepre të mëshirës.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë ditë dhe i Lumi Gjoni Pali II ndërmjetësoftë për të gjithë ata që janë duke na ndihmuar në këtë projekt të Radio Marisë.

Emanuele Ferrario
President i Familjes botërore të Radio Marisë

FREKUENCA E FORTË E RADIO MARISË ËSHTË DASHURIA



Në datat 5-8 prill ishte në mesin tonë z. Bernhard Mitterutzner, Koordinator i Familjes Botërore për Evropën, i cili zhvilloi një kurs mësimor për organizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm në koordinimin dhe promovimin e radios. Don Preka, drejtori i Radio Marisë, zhvilloi një bashkëbisedim me të në studio për ta njohur dëgjuesin me më shumë hollësi rreth kësaj vizite. Pikat kryesore të cekura nga z. Mitterutzner në këtë intervistë po i japim më poshtë edhe për ju të dashur lexues.


Pas falënderimeve që pranoi nga drejtori dhe presidentja e Radios, ai u shpreh se gjatë gjithë kohës është ndjerë si në shtëpinë e vet. I falënderoi të gjithë për pranimin dhe mikpritjen, por veçanërisht i falënderoi të gjithë për Radio Marinë, e cila këtu në Shqipëri bëhet gjithnjë e më shumë një dëshmi e gjallë për këdo.

Pyetjes se cila është përvoja e tij me radiot e tjera në Evropë dhe më gjerë lidhur me promovimin dhe organizimin e vullnetarëve, ai

përgjigjet kështu: *“Para se gjithash Radio Maria (RM) mbetet një familje e madhe dhe këtë gjë ju e dini dhe e jetoni për çdo ditë. Dhe në familje është e nevojshme që gjërat të bëhen çdo ditë nga secili dhe ky është sekret i punës së secilës RM. Që kur të bëjmë diçka të bëjmë sa më shumë miq së bashku. Dhe kjo është sikur gjithmonë në jetë, çdo festë, çdo gjë në jetë jeton prej gëzimit dhe entuziazmit që e kanë të gjithë, por edhe secili, dhe si RM ne duhet të mësojmë gjithnjë e më mirë të sensibilizojmë dhe t’i përfshijmë të gjithë në këtë punë. Jam i bindur se secili ka për të dhënë diçka. Të japësh në kuptimin e krishterë d.m.th të mos humbësh, por të fitosh. Në qoftë se në jetën tonë e zbulojmë një herë këtë formë të dashurisë, atëherë promovimi dhe rritja e RM-së bëhet gjithnjë e lehtë. Forca e secilës radio është gjithmonë forca dhe ndihmesa e secilit dëgjues. Nuk është as më shumë, as më pak. Çelësi është se përmes RM e marrim dashurinë dhe pastaj atë dashuri ne dëshirojmë ta ndajmë. Ne bëjmë të njëjtën gjë që kanë bërë apostujt, të cilët thanë “ne nuk mund të heshtim për krejt këtë dashuri që e kemi marrë”. Sepse çdo dëgjues i RM-së mund të bëhet një misionar i vogël i dashurisë, duke i këshilluar tjetrit ta dëgjojë radion dhe aty shpjegohet krejt Ungjilli. Bileta më e rëndësishme në RM jeni ju dëgjuesit. Në qoftë se jeta juaj shndërrohet dhe bëhet një jetë dashurie, jetë paqeje, atëherë të tjerët do ta pyesin vetën se si është e mundur, pasi edhe unë e kërkoj këtë paqe. Për këtë arsyeje, ju me jetën tuaj të jeni dëshmitarë të parë të RM-së, pastaj gjërat e tjera i kryen Zoja. Sa herë që shikoni diku se dikush interesohet pak, ju duhet ta shumoni gëzimin tuaj, dashurinë tuaj. Por, mos i bëni gjërat me dhunë. Edhe kur dikush na thotë se nuk na do, ne duhet vetëm ta lavdërojmë Jezusin. Duhet të jeni të ndjeshëm për nevojat e të afërmeve tuaj. Nëse dikush ka probleme me shëndetin dhe në RM ka një emision për shëndetin, atëherë thuajini atij njeriu që ta dëgjojë emisionin. Nëse vëreni se dikush është i trishtuar, atëherë tregojini se ju e keni gjetur gëzimin në këtë emision të RM-së, e ndoshta ky do ta ndihmojë edhe atë. Në këtë mënyrë ju keni hapur shumë dyer dhe pastaj mos harroni se Zoja është ajo që i përcakton gjërat, sepse çdo dëgjues është një person i thirrur prej Zotit. Sot të gjithë jeni të thirrur prej Zotit. Ju falënderoj se ju luteni shumë për thirrje.”*

Në fund të emisionit, ai shtoi edhe: *“Fjala e fundit që dëshiroj ta ndaj me dëgjuesit është pas dy javësh e kemi festën e të gjitha festave, që është Pashka. Ju kërkoj që gjatë kësaj kohe deri në Pashkë të kërkonit afërsinë me Zotin, i cili në këtë kohë qan dhe vuan. Ai nuk është larg jush, sepse Ai është afër dhe qan e vuan në të afërmin tuaj. Dhe po kërkoj prej secilit prej jush që gjatë këtyre dy javëve ta ngushëlloni Jezusin në të afërmin tuaj e kështu ia bëni një gëzim tepër të madh Zojës. Dhe jepjani një forcë të veçantë frekuencës së vërtetë të Radio Marisë që është Dashuria. Ju uroj secilit prej jush një gëzim të pafund në Ringjalljen e Zotit, sepse është gëzimi ai që i bind të gjithë. Ju falënderoj për dashurinë dhe gëzimin tuaj.”*

KISHA LUMTURON PAPA GJONIN PALIN II



Më 1 maj 2011, në ditën e Mëshirës Hyjnore, Kisha shpalli të Lumë Papën Gjonin Palin II, që njihet edhe si Papa i të rinjve. Thirrja e tij “Hapjani plotësisht zemrat Krishtit!” shndërroi zemrat e miliona të rinjve në të pesë kontinentet. Mbi 1,5 milionë besimtarë nga e gjithë bota kishin tejbushur Vatikanin për ta falënderuar Zotin për këtë Papë të madh, që me jetën e tij u kishte dhënë atyre fuqi shpirtërore në kohë të forta e vendimtare të besimit. Përkundër të gjitha parashikimeve meteorologjike për një mot me shi, qielli ka shkëlqyer dhe ka ngrohur në atë ditë si kurrë më parë. Ekranë të mëdhenj mundësonin ndjekjen e Meshës në rrugë e sheshe. Fillimisht u lut Kurorëza e Mëshirës Hyjnore, që u këndua në disa gjuhë të ndryshme. Një duartrokkitje e fuqishme shpërtheu kur Papa Benedikti XVI kumtoi fjalët “Papa Gjoni Pali II është i Lumtur”. Në çastin e kungimit, të gjithë meshtarët u shpërndanë për ta ushqyer popullin me Bukën e Qiellit, Jezusin e gjallë. Ishte vertet i mrekullueshëm ky çast, që na kujton pjesën e Ungjillit ku Jezusi ushqen 5000 vetë e u thotë Apostujve “Jepuni të hanë”. Edhe sot pas 2000 vjetësh, Kisha e ruan të paprekur këtë urdhër të Krishtit për ta kremtuar Darkën e Zotit, duke

besuar thellë se ushqehemi me Trupin e Gjakun e Krishtit sa herë që marrim pjesë në Kungimin e Shenjtë. Dita e lumturimit përfundoi me vizitën në Bazilikën e Shën Pjetrit për t’i bërë nderimet Papa Gjonit Palit II dhe për t’u lutur pranë trupit të tij. Organizatorët, forcat e rendit e të ndihmës së shpejtë dhe vullnetarët e panumërt kanë bërë një punë të mrekullueshme e të palodhur për të siguruar që çdo gjë atë ditë të shkente siç duhet. E falënderoj Zotin nga thellësia e zemrës që ma mundësoi të jem e pranishme aty në atë ditë të shënuar, të cilën do ta ruaj me shumë dashuri si një ndër kujtimet e mia më të bukura.

Maria Katerina

E MËRKURA E MADHE - ADHURIM NË KAPELËN E RADIOS NË SHKODËR



Të Mërkurën e Madhe, më datë 20 prill, Radio Maria organizoi ditë lutjeje e adhurimi në kapelën e radios në Shkodër si shenjë falënderimi Zotit për miqtë dhe bamirësit e Radio Marisë si dhe që numri i miqve dhe bamirësve të Radio Marisë të shtohet.

Lutja dhe adhurimi u udhëhoqën nga drejtori i programeve të Radio Marisë, Dr. Don Prekë Lazraj. Aty morën pjesë edhe bamirësit e radios, të cilët erdhën gjatë gjithë ditës nga Shkodra dhe rrethinat e saj.

Në këtë ditë u kremtuan tri meshë për miqtë dhe bamirësit si dhe për shtimin e tyre. Meshën e parë e kremtoi Don Mark Shtjefni në orën 7:30, ndërsa në orën 10:00 dhe 18:00, meshët u kremtuan nga Don Preka. Në lutje morën pjesë drejtpërdrejt edhe dëgjuesit përmes telefonit, si edhe ata që ishin në kapelën e Nënë Terezës në Shkodër.

Një fjalë të shkurtër ua drejtoi besimtarëve edhe presidentja e Radio Marisë, znj. File Preka. Në pritjen e bamirësve ndihmuan edhe vetë dëgjuesit (milingonat) dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të radios gjatë paradites, ndërsa pasdite ndihmuan edhe vullnetarët e brendshëm të radios.

Në meshë ndihmuan edhe motrat Bijat e Dashurisë Hyjnore dhe Bashkësia e Shën Jozefit në Shkodër. Lutja dhe adhurimi përfunduan me kremtimin e Meshës së shenjtë në orën 18:00, në të cilën ndihmuan edhe motrat Bijat e Dashurisë së Krishterë (Motrat Vinçenciane) të bashkësisë së Shkodrës.

Falënderojmë Zotin për drejtimin dhe shndritjen që Ai e bën në ne. Ia porosisim Zotit, me ndërmjetësinë e Nënës, secilin mik dhe bamirës të Radio Marisë që për 8 vite e ndihmon në mënyrë të vazhdueshme Radio Marinë, por edhe secilin mik dhe bamirës që do të jetë në të ardhmen mik i vazhdueshëm i Radio Marisë me ndihmën e tij në lutje, angazhim, ndihmë, etj. Zoti ju shpërbleftë me të mirat e tij dhe me dashurinë e tij. Ju shoqërojmë me lutjen tonë të vazhdueshme.

Orselina

FESTA E MËSHIRËS HYJNORE NË RADIO MARI



Përgatitja për të Kremten e Mëshirës Hyjnore filloi të Premten e Madhe me ditën e parë të nëntëditëshit. Radio Maria e kremtoi të dielën e Mëshirës Hyjnore më 1 maj në kapelën e Mëshirës Hyjnore në Tiranë. Së bashku me vullnetarët dhe dëgjuesit, Don Preka drejtoi lutjen e ruzares, kurorëzës dhe litanitë e Mëshirës Hyjnore. Dhe menjëherë pas tyre, ai vazhdoi me kremtimin e Meshës së Shenjtë.

Ishte një kënaqësi dhe një dhuratë e Zotit që në javën e përgatitjes për festën e Mëshirës Hyjnore të kishim si pjesë të familjes botërore të Radio Marisë në mesin tonë z. Emanuele Ferrario, president i Radio Marisë Botërore. Me të e zhvilluam edhe një emision në studio. Pjesë nga biseda e tij i kemi përmbledhur në artikullin e faqes 2.

Ai e sheh Radio Marinë Shqiptare si “një mrekulli të vogël” që ka arritur objektiva të paimagjinuara dhe në

një kohë shumë të shpejtë. Ai përforcoi edhe njëherë pohimin se Radio Maria është Misionare, është Fjalë e Dashurisë dhe e Mirësisë.

Gjatë bisedimit dhe komunikimit me dëgjuesit, njëra prej dëgjueseve të rregullta, Gjystja, tha: “Do të doja që ta kisha Radio Marinë si relikte, të cilën mund ta vendosja në qafë e të mund ta merrja ngado që shkoj dhe nuk do ta hiqja kurrë nga qafa”.

E dimë të dashur dëgjues, se gjithçka që e kemi arritur, e kemi arritur së bashku, falë dashurisë tuaj të madhe për Jezusin dhe Zojën e Bekuar. Pa ndihmat dhe lutjet tuaja të vazhdueshme, Hiri i Hyjit nuk do të kishte depërtuar kaq shpejt dhe kaq mirë në zemrat dhe shtëpitë e shumë shqiptarëve anembanë botës. Kjo është me të vertetë një vepër mëshire që Zoja e Bekuar ia ka dhuruar popullit tonë. E falënderojmë Zotin në këtë ditë të Mëshirës Hyjnore për ju dhe për të gjithë ata që do t’ju bashkëngjiten në këtë rrugë të bukur, që Hyji ta shtojë në ju ndjenjën e Mëshirës për ta çuar përpara këtë vepër Ungjillëzimi në vitet në vazhdim për të gjithë brezat e ardhshëm.



PRO CREDIT BANK

LLOGARIA NË EURO 127837030002

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 0520911240000127837030002

LLOGARIA NË LEK 127837030101

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 4820911240000127837030101

INTESA SAN PAOLO BANK

LLOGARIA NË EURO 1043631803

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 25208110080000001043631803

LLOGARIA NË LEK 1043631801

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 79208110080000001043631801

NË ZVICËR ME 5 FRANGA

Duke telefonuar në numrin:

0900123411

Në bankën CREDIT SUISSE

RADIO MARIA

LLOGARIA NË CHF 361173-10-1

IBAN: CH1804835036117310001